

Sektor i veprave penale të Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut, në bazë të nenit 68 nga Rregullorja gjyqësore ("Gazeta Zyrtare e RM" nr. 66/2013 dhe 114/2014), si dhe nenet 31, 32 dhe 33 nga Rregullorja e punës së Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut ("Gazeta Zyrtare e RMV" nr. 14/2022 të datës 20 janar 2022), në seancën e mbajtur më 16.02.2022, miratoi:

## **MENDIM JURIDIK**

**Dita kur i akuzuari futet në Institutin ndëshkues penal për vuajtjen e dënimit me burg, llogaritet si ditë kur rrjedh afati i parashkrimit të ekzekutimit të dënimit me burg.**

**Paraburgimi ekstradues është masë e sigurimit të prezencës së të akuzuarit dhe koha e kaluar në paraburgimin ekstradues llogaritet në vuajtjen e dënimit me burg dhe nuk mund të konsiderohet si ditë kur fillon ekzekutimi i dënimit me burg.**

## **A r s y e t i m**

Sektor i veprave penale të Gjykatës së Apelit Manastir dorëzoi kërkesë SU.nr.03-22/22 të datës 21.01.2022 në Sektorin e veprave penale të Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut, në të cilën është parashtruar çështja juridike: "Nëse dita kur personi i dënuar është vendosur në paraburgim ekstradues në një shtet tjetër, dhe pas flet arrestit ndërkombëtar paraprakisht të lëshuar nga një gjykatë maqedonase, llogaritet si ditë kur fillon ekzekutimi i dënimit me burg i personit të akuzuar dhe nga ajo ditë përcaktohet se ka filluar parashkrimi absolut i ekzekutimit të dënimit me burg, sipas nenit 111 paragrafi (5) të Kodit penal.

Sektor i veprave penale të Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut, në seancën e mbajtur më 31.01.2022, shqyrtoi për çështjen e parashtruar juridike dhe konstaton se dita kur i akuzuari do të hyjë në Institutin ndëshkues penal për vuajtjen e dënimit me burg, llogaritet si ditë deri kur rrjedh afati i parashkrimit të ekzekutimit të dënimit me burg.

Paraburgimi ekstradues është masë e sigurimit të prezencës së të akuzuarit. Koha e kaluar në paraburgim/paraburgim ekstradues, si dhe çdo privim nga liria në lidhje me vepër penale, llogariten në dënimin e shqiptuar, sipas nenit 47 paragrafi (1) të Kodit penal dhe nuk mund të konsiderohet si ditë kur fillon ekzekutimi i dënimit me burg.

Duke marrë parasysh të theksuarën, Gjykata Supreme e Republikës së Maqedonisë së Veriut konstaton se posaçërisht është i rëndësishëm miratimi i Mendimit juridik, që do t'iu ndihmojë gjykatave më të ulëta në zbatimin e dispozitave ligjore nga neni 111 paragrafi (5) të Kodit penal, që të pamundësohet mos-harmonizimi me zbatimin e qasjes së unifikuar dhe më të sistemuar gjatë procedimit.

**Sektor i veprave penale**